



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 57
Prishtinë, më 1.11.2016, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVE R BAL

I Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, nënkryetar, Mufera Sinik, nënkryetar i dytë, Kimete Bytyqi, Ali Berisha, Fisnik Ismaili, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi, anëtarë.

Munguan: Jasmina Živković, Saša Milosavljević, Slavko Simić dhe Milka Vuletić.

Në mbledhje morën pjesë: monitoruesi i OSBE-së dhe anëtari i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Nga zyrtarët për përkrahje: koordinatori i komisionit

Mbledhjen e kryesoi: Agim Çeku, nënkryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-117 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
5. Të ndryshme

Nënkryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore, me amendamentet e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;

Agim Çeku, nënkryetar, ka theksuar se ky projektligj, me amendamente të paraqitura nuk shkelin dhe nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i njëjti mund të miratohet pa vërejtje.

Fisnik Ismaili:Me këtë Projektligj përcaktohen parimet, procedurat, kushtet dhe rregullat për lejimin, monitorimin dhe revokimin e ndihmës shtetërore, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat përmbajnë dispozita për ndihmë shtetërore, të ratifikuar nga Republika e Kosovës. GP Vetëvendosjekëtë Projektligj nuk e ka miratuar në parim dhe ka paraqitur vërejtje, duke kërkuar nga ministria resorë një sërë përgjigje, të cilat ende nuk i kemi marrë. Prandaj, unë do të jem i rezervuar me rastin e votimit.

Meqenëse nuk kishte diskutime të tjera, pas rezultatit të votimit 7 për dhe 1 të rezervuar , Komisioni nxjerr këtë:

Përfundim

Projektligji nr. 05/L-100, me amendamente të paraqitura nuk shkelin dhe nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i rekomandohet Kuvendit që të njëjtin ta miratojë në shqyrtimin e dytë.

Nënkryetari e hap diskutimin lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me amendamentet e Komisionit Funkcional për buxhet dhe financa;

Fisnik Ismaili: GP i Vetëvendosjes e ka kundërshtuar miratimin e këtij Projektligji në mbledhjen plenare, sepse i njëjti ka shumë probleme, kështu që do të votojë kundër miratimit të tij.

Meqenëse nuk kishte diskutime të tjera, pas rezultatit të votimit 7 për dhe 1 kundër, Komisioni nxjerr këtë:

Përfundim

Projektligji nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168, me amendamentet e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa nuk shkel dhe nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i Rekomandohet Kuvendit miratimi i të njëjtit në shqyrtimin e dytë.

Nënkryetari e hap diskutimin lidhur me pikën e katërt të rendit të ditës

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-117 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Meqenëse nuk kishte diskutime lidhur me këtë projektligj, pas rezultatit të votimit 7 për dhe 1 të rezervuar (Fisnik Ismajli), Komisioni nxjerr këtë:

Përfundim

Projektligjit nr. 05/L-117 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk shkel dhe nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i rekomandon Kuvendit miratimin e të njëjtit në shqyrtimin e dytë.

5. Të ndryshme

Qerim Bajrami ka potencuar disa çështje që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe kompetencat e komisionit:

- a) Që grupi punues ta përgatis raportin me rekomandime për monitorimin e Ligjit për Shërbimin Civil, të cilin paraprakisht do ta shqyrtojë komisioni, ndërsa pas miratimit të tij në Komision i njëjti do t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.
- b) Që administrata e Komisionit ti dërgojë ftesë zyrtare Drejtorit të Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit për raportim në mbledhje të komisionit lidhur me implementimin e buxhetit të ndarë për Zyrën për çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit për vitin fiskal 2016.
- c) Që administrata e Komisionit ti dërgojë ftesë zyrtare për Kryetarin e dhe Drejtorin e Bordit të RTK-së për të raportuar lidhur me përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në sektorin e ofrimit të shërbimeve mediale në pajtim me Ligjit për RTK.

Pas propozimeve të paraqitura, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohen propozimet e deputetit Çerim Bajrami dhe ngarkohet administrata e Komisionit që të angazhohet lidhur me ftesat, terminët dhe datat e mbajtjes së raportimit. Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

**Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Nënkryetari i Komisionit,

Agim Çeku